



## **Masa të reja parandaluese kundër COVID-19**

Këshilli i Ministrave ka përcaktuar masa të reja parandaluese ndaj COVID-19 nëpërmjet Aktit Normativ nr. 30, datë 20.07.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Aktin Normativ nr. 3 datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës të infeksionit të shkaktuar nga COVID-19" (Akti Normativ ndryshues nr. 30) , si më poshtë:

- Ndalimin e hapjeve të klubeve të natës, diskove, lounge-bareve dhe çdo lloj shërbimi të kësaj natyre në mjedis të mbyllur apo të hapur. Mosrespektimi i këtij detyrimi dënohet me gjobë 3 000 000 (tre milion) lekë dhe me pezullim të aktivitetit për një periudhë 1 (një) vjeçare.
- Ndalimin e muzikës pas orës 20:00 në të gjithë mjediset e shërbimeve të çfarëdolloji. Mosrespektimi i këtij detyrimi nga subjektet dënohet me gjobë 1 000 000 ( një milion ) lekë dhe në rast përsëritje, me pezullim të aktivitetit për një periudhë 6 (gjashtë) mujore.

Institucioni përgjegjës për zbatimin e këtyre masave është Policia e Shtetit.

Ky Akt Normativ ka hyrë në fuqi menjëherë, pra nga data e vendimmarrjes 20 (njëzet) Korrik 2020.

## **The new preventive measures taken against COVID-19**

The Council of Ministers has determined new preventive measures against COVID-19, through the Normative Act no. 30, dated 20.07.2020 "On some amendments and additions to the Normative Act no. 3, dated 15.3.2020, of the Council of Ministers, "On special administrative measures during the infection period caused by Covid-19" (The Amending Normative Act no. 30), as follows:

- The prohibition of the opening of nightclubs, disco clubs, lounge-bars and any kind of service of this nature in closed or open premises. Non-compliance with this obligation is punished with a fine in the amount of 3 000 000 (three million) ALL and with the suspension of the activity for a period of 1 (one) year.
- The prohibition of music after 20:00 (8 pm) in all premises that provide service of any kind. Non-compliance of the subjects with this obligation is punished with a fine in the amount of 1 000 000 (one million) and in case it is a repeated act, with the suspension of the activity for a period of 6 (six) months.

The responsible institution for the observance of these measures is the State Police.

This Normative Act entered into force immediately, thus from the date of the decision on 20 (twenty) July 2020.